



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI KËSHILLIT

Nr. 324/11 Prot

Gramsh më, 05.06.2021

**VENDIM**  
Nr. 91 dt. 29/06/2021  
Për

**“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e zj. Azbie Hoxholli, banor në fshatin Kishtë, Njësia Administrative Kodovjat, si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Azbie Hoxholli**, banor në fshatin Kishtë, Njësia Administrative Kodovjat, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $349\ 392 \times 50\% = 174\ 696$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Zj. Azbie Hoxholli** është në **174 696** (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **174 696** (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë **Zj. Azbie Hoxholli**.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektori i Emergjencave Civile ).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini  
Pranoi: G. Lena  
Miratoi: G. Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

